



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:149432

Datë: 01.02.2021

Numri i dokumentit: 01460086

PKR.nr.207/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Krimeve të Renda, Kryetari i Trupit Gjykes - Gjykatësi **Drilon Haraçia**, me zyrtaren ligjore Arbënore Basha, në lëndën penale kundër të akuzuarve A. (B.) M. nga fsh. . . , Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 pika 1.4. të KPRK-së, veprës penale të Kanosjes nga neni 181 par.2 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i akuzuari K. (Q.) M. nga fsh. . . , Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 lidhur me nenin 31 KPRK-së, i akuzuari K. (Q.) M. nga fsh. . . , Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nënpar.3.2 lidhur me neni 31 të KPRK-së, e akuzuara L. (Q.) M. nga fsh. . . , Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe i akuzuari Q. (A.) M. nga fsh. . . , Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 pika 3.2. të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.nr.714/19 të dt.13.08.2019, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar publik, **me datë 28.01.2021**, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ramiz Buzhala dhe të akuzuarve, **me dt.01.02.2021** mori dhe publikisht shpalli dhe e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarve:

A. M., nga i ati B. dhe e ëma A, e gjinisë Z., data e lindjes . . . në fshatin . . . , Komuna e Malishevës, ku dhe tani banon, ka të kryer shkollën e mesme deri në vitin e 2-të, i martuar, baba i 3 fëmijëve, i papunë, i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar/Kosovar, nr.Personal: . .

K. M., nga i ati Q. dhe e ëma H., e gjinisë G., data e lindjes . . në fshatin . . . , Komuna e Malishevës, ku dhe tani banon, ka të kryer shkollën e mesme, i pamartuar, punëtor-kamerier, i gjendjes se mirë ekonomike, shqiptar/Kosovar, nr.Personal: . .

K. M., nga i ati Q. dhe e ëma H., e gjinisë G., data e lindjes . . . në fshatin . . . , Komuna e Malishevës, ku dhe tani banon, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, punëtor - kamerier, i gjendjes se mirë ekonomike, shqiptar / Kosovar, nr.Personal: . .

L. M., nga i ati **Q.** dhe e ëma **H.**, e gjinisë **G.**, data e lindjes . . . në fshatin . . . , Komuna e Malishevës, ku dhe tani banon, ka të kryer Fakultetin filozofik Dega Histori, e martuar, e papunë, e gjendjes se mirë ekonomike, shqiptare Kosovare, nr.Personal: . . .

Q. M., nga i ati **A.** dhe e ëma **H.**, e gjinisë **G.**, data e lindjes . . . në fshatin . . . , Komuna e Malishevës, ku dhe tani banon, ka të kryer shkollën fillore-5 vite, i martuar, baba i 3 fëmijëve, i papunë, i gjendjes se mirë ekonomike, shqiptar/Kosovar, nr.Personal: . . .

J A N Ë F A J T O R

I akuzuari A. M.:

I. Sepse me dt.18.05.2019 tek shtëpia e tij në fsh. . . . , Komuna e Malishevës, tjetrit i shkakton lëndime të lehta trupore me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, ashtu që pas përlëshjes së zhvilluar në mes tij si i pandehur dhe djalit të axhës së tij **K.**it tani i dëmtuar, e rrëzon për toke ashtu që në përlëshje e sipër të njëjtit i shkakton lëndime të lehta trupore të konstatuara nga ekspertiza e ekspertit mjeko – ligjore **Dr.F. B.** të dt.16.07.2019.

Me këto veprime ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 parag.1 pika 1.4 të KPRK-së.

II. Sepse me dt.18.05.2019 tek shtëpia e tij në fsh. . . . , Komuna e Malishevës, seriozisht i kanos personat tjerë se do të iu shkaktojë ndonjë të keqe, se do ti vras. Ashtu që pasi ishte goditur nga të pandehurit **K. M.**, **K. M.**, **L. M.** dhe **Q. M.**, shkon menjëherë tek vetura e tij që gjendej aty afër dhe nxjerr revolen e tipit “Zastava” 6.35 mm duke ia drejtuar të njëjtën, me çka në këtë mënyrë ka shkaktuar për të dëmtuarit **K.**, **K.L.** dhe **Q. M.**, kanosje serioze me fjalë dhe vepra se do ti provojë nga jeta apo do të iu shkaktojë lëndime të rënda trupore duke iu shkaktuar kështu frikë dhe pasiguri për jetën dhe trupin e tyre.

Me këto veprime ka kryer veprën penale kanosje nga neni 181 parag.2 të KPRK-së.

III.Sepse me dt.18.05.2019 tek shtëpia e tij në fsh. . . . , Komuna e Malishevës, mban në pronësi, kontroll ose posedim armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët e tilla, ashtu që i njëjti ka mbajtur armën e tipit “Zastava” 6.35 mm, me numër serik T671047 dhe një karikator pa fishek, pa leje përkatëse, me çrast pas kontrollit policor ka rezultuar dhe e njëjta është konfiskuar.

Me këto veprime ka kryer veprën penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 parag.1 të KPRK-së.

Të akuzuarit K. M. dhe Q. M.

IV. Sepse me dt.18.05.2019 tek shtëpia e të dëmtuarit në fsh. . . . , Komuna e Malishevës, tjetrit i shkaktonjë lëndime trupore me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, ashtu që ditën kritike pas një mosmarrëveshje në mes të dëmtuarit **A. M.** në njërën anë dhe djalit të axhës së tij **K.**in në anën tjetër, dy të pandehurit shkojnë në oborrin e të dëmtuarit **A.** dhe e godasin me

shkopinj druri në trup, duke i shkaktuar kështu lëndime të lehta, gjendje kjo e konstatuar nga ekspertiza mjeko – ligjore nga Dr.F. B. e dt.16.07.2019

Me këto veprime kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Të akuzuari K. M. dhe L. M.

IV. Sepse me dt.18.05.2019 tek shtëpia e të dëmtuarit në fsh., Komuna e Malishevës, për shkak të një fjalosje verbale që kishte pasur më herët i dëmtuari A., fillimisht me L. M., e godasin edhe këta dy ashtu që K.i ashtu siç e sulmonte babai i tij Q.i dhe K.i ky e ka godit me grusht në trup, ndërsa L. e ka ngrehur për flokë si dhe duke e gërvishur në trup.

Me këto veprime ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par. 1, 31, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, 70, dhe neneve 185 par.1 dhe 2 lidhur me par. 1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe nenit 181 par.2 të KPRK-së, nenin 366 par.1 dhe 3 të akuzuarve iu shpall dënimet si vijon:

Të Akuzuarit A. M.; i shqipton veç e veç dënimet për secilën vepër penale dhe atë:

- **Për veprën penale nën. I** të dispozitivit të këtij vendimi me **Dënimin me Burgim** në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muaj.
- **Për veprën penale nën. II** të dispozitivit të këtij vendimi me **Dënimin me Burgim** në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj.
- **Për veprën penale nën. III** të dispozitivit të këtij vendimi me **Dënimin me Burgim** në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj.

Të akuzuarit K. M., i shqipton dënimin për vepër penale dhe atë:

- **Për veprën penale nën. IV** të dispozitivit të këtij vendimi me **Dënimin me Burgim** në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muaj.

Të akuzuarit Q. M. i shqipton dënimin për vepër penale dhe atë:

- **Për veprën penale nën. IV** të dispozitivit të këtij vendimi me **Dënimin me Burgim** në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muaj.
-

Të akuzuarit K. M. i shqipton dënimin për vepër penale dhe atë:

- **Për veprën penale nën. V** të dispozitivit të këtij vendimi me **Dënimin me Burgim** në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muaj.

Të akuzuarës L. M., i shqipton dënimin për vepër penale dhe atë:

- **Për veprën penale nën. V** të dispozitivit të këtij vendimi me **Dënimin me Burgim** në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muaj.

Andaj gjykata konform nenit 76 të KPRK-së, të akuzuarit i:

G J Y K O N

TË AKUZUARIN A. M.

ME DËNIMIN UNIK ME BURGIM në kohëzgjatje prej **14 (katërbëdhjetë) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej 2 (dy) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Ndaj të akuzuarit A. M., bëhet konfiskimi i: një (1) pistoletë të tipit Zastava, të kalibrit 6.35 mm, me nr. Serik T 671047, një karikator pa fishekë, si objekte të kryerjes së veprës penale.

I akuzuari A. M., lirohet nga shpenzimet e procedurës penale, dhe të njëjtat bien në llogari të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

TË AKUZUARIN K. M.

Për veprën penale nën. IV të dispozitivit të këtij vendimi, **ME DËNIMIN ME KUSHTË**, duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **7 (shtatë) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 (një) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Detyrohet i akuzuarit K. M. që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë për ekspertizë mjeko ligjore shumë prej 5 Euro, shpenzimet e paushallin gjyqësor në shumë prej 30 Euro, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

TË AKUZUARIN Q. M.

Për veprën penale nën. IV të dispozitivit të këtij vendimi, **ME DËNIMIN ME KUSHTË**, duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **7 (shtatë) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 (një) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari Q. M., që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë: për ekspertizat mjeko ligjore shumë prej 5 Euro, shpenzimet e paushallin gjyqësor në shumë prej 30 Euro, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

TË AKUZUARIN K. M.

Për veprën penale nën. V të dispozitivit të këtij vendimi, **ME DËNIMIN ME KUSHTË**, duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **7 (shtatë) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 (një) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari K. M., që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë: për ekspertizat mjeko ligjore shumë prej 5 Euro, shpenzimet e paushallin gjyqësor në shumë prej 30 Euro, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

TË AKUZUAREN L. M.

Për veprën penale nën. V të dispozitivit të këtij vendimi, **ME DËNIMIN ME KUSHTË**, duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **7 (shtatë) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 (një) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Detyrohet e akuzuara L. M. që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë: për ekspertizat mjeko ligjore shumë prej 5 Euro, shpenzimet e paushallin gjyqësor në shumë prej 30 Euro, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate, ka ngritur aktakuzën me numër PP.nr.714/19 të dt.13.08.2019, kundër të akuzuarve: A. (B.) M. nga fsh. . . , Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 pika 1.4. të KPRK-së, veprës penale të Kanosjes nga neni 181 par.2 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i akuzuari K. (Q.) M. nga fsh. . . , Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 lidhur me nenin 31 KPRK-së, i akuzuari K. (Q.) M. nga fsh. . . , Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nënpar.3.2 lidhur me neni 31 të KPRK-së, e akuzuara L. (Q.) M. nga fsh. . . , Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe i akuzuari Q. (A.) M. nga fsh. . . , Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 pika 3.2. të KPRK-së.

Prokurori i Shtetit Ramiz Buzhala në shqyrtimi fillestar ka deklaruar se mbesë në tërësi pranë akuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP.nr.714/19 të datës 13.08.2019, ku para lëximit të aktakuzës ka bërë rregullimin e dispozitivit të parë dhe të dytë të aktakuzës tek kualifikimi i veprës penale ashtu që në vend të kualifikimit me çka ka kryer vepër penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 të KPRK-së, duhet të jetë “me çka ka kryer vepër penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4. të KPRK-së” meqenëse në rastin konkret të dëmtuarit nuk janë viktimat të ndjeshme konform dispozitave të KPRK-së dhe në rastin konkret janë përdorur mjetet e forta, që është kusht ligjor për kualifikimin e veprës.

I akuzuari A. M., në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale nga pika e 3-të, pika e 4-të dhe pika e 5-të, e aktakuzës për të cilat akuzohem, shtonë se është penduar, me palën e dëmtuar jemi pajtuar dhe nuk kemi asgjë të keqe, i propozojë gjykatës që ndaj meje të më shqiptojë dënim sa më të lehtë.

I akuzuari K. M., në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë sipas pikës si në pikën 2, e cila i vihet në barrë, shtonë se është penduar me palën e dëmtuar jemi pajtuar dhe nuk kemi asgjë të keqe, i propozojë gjykatës që ndaj meje të më shqiptojë dënim sa më të lehtë.

I akuzuari K. M., në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale sipas pikës së 1 të aktakuzës, e cila i vihet në barrë, shtonë se është penduar me palën e dëmtuar jemi pajtuar dhe nuk kemi asgjë të keqe, i propozojë gjykatës që ndaj meje të më shqiptojë dënim sa më të lehtë.

E akuzuara L. M., në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale sipas pikës 2 të aktakuzës, e cila i vihet në barrë, shtonë se është penduar me palën e dëmtuar jemi pajtuar dhe nuk kemi asgjë të keqe, i propozojë gjykatës që ndaj meje të më shqiptojë dënim sa më të lehtë.

I akuzuari Q. M., në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale sipas pikës së 1 të aktakuzës, e cila i vihet në barrë, shtonë se është penduar me palën e dëmtuar jemi pajtuar dhe nuk kemi asgjë të keqe, i propozojë gjykatës që ndaj meje të më shqiptojë dënim sa më të lehtë.

Prokurori i Shtetit Ramiz Buzhala duke dhënë mendimin lidhur me fajësisë nga ana e të akuzuarve ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, pasi të njëjtit i kuptuan natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprat penale për të cilat ngarkohen, pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurve bëhet me vetëdije dhe vullnet të plotë, si dhe pranimi i fajësisë mbështetet në provat dhe faktet në të cilat bazohet dhe që janë bashkangjitur aktakuzës, andaj për këto arsye i propozojë gjykatës që të aprovojë pranimin e fajësisë.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, Kryetari i Trupit Gjykses pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve A. M., K. M., L. M. dhe Q. M., ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë Kryetari i Trupit Gjykses, konstatoi se të akuzuarit i kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarve, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjykses ka vërtetuar këto gjendje faktike:

- Se i akuzuari A. M., me dashje ka kryer vepra penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 pika 1.4 të KPRK-së dhe veprës penale kanosje nga neni 181 par.2 të KPRK-së, dhe veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin I, II dhe III të këtij Aktgjykimi.

- Se i akuzuari K. M., me dashje ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin IV të këtij Aktgjykimi.

- Se i akuzuari Q. M., me dashje ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin IV të këtij Aktgjykimi.

- Se i akuzuari K. M., me dashje ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin V të këtij Aktgjykimi.

- Se i akuzuari L. M., me dashje ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin V të këtij Aktgjykimi.

4. Elementet e veprave penale

Në nenin 185 par.1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale lëndimi të lehtë trupor e kryen: “Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor”, ndërsa nën paragrafi 1.4 ka përcaktuar se “kur kemi dëmtim të përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit”. Ndërsa paragrafi 2 ka përcaktuar se: “kur vepra penale nga paragrafi 1 kryhet me armë, mjet të rrezikshëm apo me ndonjë send tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muajve deri në pesë (5) vjet.”

Në nenin 181 par.2 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale “Kushdo që seriozisht i kanoset personit tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do ta privoj nga jeta ose de do ti shkaktojë lëndim të rëndë trupor, se do ta rrëmbejë ose privoj nga liria ndonjë person tjetër ose se do ta dëmtojë me armë zjarri, me shpërthim ose me jete të tjera të rrezikshme, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vitë”.

Në nenin 366 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se këtë formë të kësaj vepre penale e kryen “Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet”. Ndërsa, në Ligjin për armët, është parashikuar se për të mbajtur në posedim apo pronësi ndonjë armë, duhet që personi të ketë leje valide të lëshuar nga organi kompetent.

5. Vendimet e Kryetari i Trupit Gjykses

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve A. M., K. M., L. M. dhe Q. M., formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së dhe veprës penale kanosje nga neni 181 par.2 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe ti gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimeve

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit A. M., gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar se i njëjti është i moshës së re, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, pajtimin me palën e dëmtuar, është mbajtës i familjes 6 anëtarësh, përfitues i ndihmës sociale, nuk ka qenë i dënuar më parë për vepra penale. Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar për të gjitha veprat penale për të cilën ngarkohet, shprehjen e keqardhjes për rastin e ndodhur. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara për të akuzuarin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së dhe këto dënime si të tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimet e shqiptuar do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit K. M., gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar se i njëjti është i moshës së re, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, pajtimin me palën e dëmtuar, nuk ka qenë i dënuar më parë. Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar për të gjitha veprën penale për të cilën ngarkohet, shprehjen e keqardhjes për rastin e ndodhur. Kështu që duke mos gjetur rrethana tjera rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara për të akuzuarin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së dhe këto dënime si të tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimet e shqiptuar do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit Q. M., gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar se i njëjti në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, pajtimin me palën e dëmtuar, nuk ka qenë i dënuar më parë. Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar për të gjitha veprën penale për të cilën ngarkohet, shprehjen e keqardhjes për rastin e ndodhur. Kështu që duke mos gjetur rrethana tjera rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara për të akuzuarin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së dhe këto dënime si të tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i

akuzuari dhe se dënimet e shqiptuar do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit K. M., gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar se i njëjti është i moshës së re, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, pajtimin me palën e dëmtuar, nuk ka qenë i dënuar më parë. Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar për veprën penale për të cilën ngarkohet, shprehjen e keqardhjes për rastin e ndodhur. Kështu që duke mos gjetur rrethana tjera rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara për të akuzuarin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së dhe këto dënime si të tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimet e shqiptuar do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarës L. M., gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarës si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar se e njëjta është e moshës së re, në gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, pajtimin me palën e dëmtuar, nuk ka qenë e dënuar më parë. Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës në shqyrtimin fillestar për veprën penale për të cilën ngarkohet, shprehjen e keqardhjes për rastin e ndodhur. Kështu që duke mos gjetur rrethana tjera rënduese për të akuzuarën, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara për të akuzuarën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së dhe këto dënime si të tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon e akuzuara dhe se dënimet e shqiptuar do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarës nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e saj, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

8. Konfiskimi

Përveç dënimit kryesor, gjykata ndaj të akuzuarit A. M., konform neneve 366 par. 3 të KPRK-së, gjykata ka bërë konfiskimin e një (1) pistoletë të tipit Zastava, të kalibrit 6.35 mm, me nr. Serik T 671047, një karikator pa fishekë, si objekte të kryerjes së veprës penale.

9. Vendimet për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi lirimin nga shpenzimet e procedurës penale për të akuzuarin A. M. është marr konform nenit 453 par.4 të KPP-së, për faktin se gjykata konsideron se me pagimin e

shpenzimeve do të rrezikohet gjendja materiale e të akuzuarit pasi që është i gjendjes shumë të varfër ekonomike, si dhe duke marr për bazë faktin është pa punë, mbajtës i vetëm i familjes si dhe faktin se të ardhurat i siguron kryesisht përmes ndihmës sociale sipas Kartelës Sociale nr.18096 të dt.01.01.2021.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 450 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i Krimeve të Rënda -
PKR.nr.207/20, me datë 01.02.2021

Zyrtarja Ligjore,
Arbënore Basha

Kryetari i Trupit Gjyqësor- Gjykatësi,
Drilon Haraçia

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjyqimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.